



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 200, datë 03.09.2018

MBI

**MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË “RREGULLAT PËR ALOKIMIN E
KAPACITETEVE TË INTERKONEKSIONIT**

Në mbështetje të neneve 16, 65, dhe nenit 97, pika 2, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar dhe nenit 26 të “Rregullave të Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 03.09.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorive Teknike në lidhje me shqyrtimin dhe miratimin e disa ndryshimeve të propozuar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a “OST” sh.a në “Rregulloren e alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 140, datë 22.11.2013, të ndryshuar me Vendimet nr. 61, datë 07.07.2014 dhe nr. 76, datë 26.05.2017,

Konstatoi se:

- Operatori i Sistemit të Transmetimit “OST” sh.a harton Rregulloren për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksionit, e cila miratohet nga ERE në zbatim të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”i ndryshuar.
- Operatori i Sistemit të Transmetimit “OST” sha, me shkresën nr. 1713 Prot, datë 28.02.2018 ka dërguar në ERE propozimin për disa ndryshimeve në vendimet nr. 140, datë 22.11.2013 dhe nr. 61, datë 07.07.2014 të Bordit të ERE, mbi “Rregullat për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksionit“ .
- Referuar Vendimit të ERE nr.12, datë 29.01.2016, “Mbi ankandet e Kapaciteteve të interkonjeksionit në kufirin me Kosovën”, OST sh.a do të zbatojë Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 140, datë 22.11.2013, të ndryshuar deri në ndryshimin e rrethanave që lidhen me pjesëmarrjen e Kosovës në Zyrën e Koordinuar të Ankandëve për Europën Juglindore. (SEE CAO).
- Operatori i Sistemit të Transmetimit “OST”sha, në të sajën sipërcituar ka bërë me dije se gjatë zhvillimit të ankandëve, vihet re se është paraqitur interes edhe nga subjekte të tjerë, të cilët nuk janë të regjistruar ende si pjesëmarrës të tregut shqiptar të energjisë elektrike. Në këto kushte lind nevoja e ndryshimit të përcaktimit “se si pjesëmarrës të ankandëve

duhet të jenë vetëm subjektet tregtare të regjistruar në Shqipëri". Ky përcaktim nuk është në përputhje me kërkesat e tregut, por gjithashtu nuk është konform parimeve, frymës dhe përcaktimeve të Ligjit nr. 43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" i ndryshuar.

- ERE me Vendimin e Bordit nr. 68, datë 26.03.2018, ka filluar procedurat për "Shqyrtimin dhe miratimin e një ndryshimi në "Rregullat për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksionit".
- ERE, publikoi për 3 ditë me rradhë në median e shkruar njoftimin për vendimmarrjen e sipërcituar të Bordit. Me anë të këtij njoftimi u ftuan të gjithë palët e interesuara për të shprehur opinionet dhe komentet e tyre brenda 15 ditëve pune.
- Me shkresën nr. 335 Prot., datë 24.04.2018, ERE dërgoi Vendimin nr. 68, datë 26.03.2018 "*Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e disa ndryshimeve në Rregullat për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksionit*", për marrje mendimi pranë subjekteve: "OST" sha, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetit të Konkurrencës, shoqatës FIAA, dhe shoqatës AREA.
- Pas përfundimit të afatit 15 ditor të marrjes së mendimeve nga palët e interesuara, rezultoi se janë paraqitur në ERE mendime nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti i Konkurrencës dhe shoqata AAES, ku shprehen në lidhje me ndryshimet e propozuar nga Shoqëria "OST" sha.
- ERE më datë 29.05.2018, organizoi një seancë dëgjimore, për të diskutuar dhe për të shprehur mendimet e tyre palët e interesit, në lidhje me këto propozime.
- Ndryshimi i propozuar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit "OST" sha konsiston në nenin 2, paragrafi 6, të "*Rregullores për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksionit*".
- Gjithashtu duke qenë se propozohet ky ndryshim në një kohë që kanë ndodhur përditësime të bazës ligjore dhe nënligjore të cilave i referohen këto rregulla, është e nevojshme të reflektohen edhe këto ndryshime në Rregullore.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Në "Rregulloren për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksionit" të bëhen ndryshimet si më poshtë:

Neni 2 paragrafi 6:

- **Ishte:** "*Pjesëmarrës i Tregut - është një entitet juridik i regjistruar në Shqipëri, i licencuar nga ERE për kryerjen e një ose më shumë aktiviteteve në sektorin energjetik*"

dhe që i është nënshtruar të gjitha procedurave të parashikuara nga aktet ligjore e nënligjore në fuqi për regjistrimin në tregun e energjisë elektrike. Është një entitet juridik i regjistruar në Shqipëri, i licencuar nga ERE për kryerjen e një ose më shumë aktiviteteve në sektorin energjetik, dhe që ka nënshkruar me OST Kontratën për përdorimin e kapacitetit ndërkufitar.

- **Bëhet:** *“Pjesëmarrës i Tregut - është një entitet juridik i regjistruar në Shqipëri, i licencuar nga ERE për kryerjen e një ose më shumë aktiviteteve në sektorin energjetik dhe që i është nënshtruar të gjitha procedurave të parashikuara nga aktet ligjore e nënligjore në fuqi për regjistrimin në tregun e energjisë elektrike. Është një entitet juridik i regjistruar në Shqipëri, i licencuar nga ERE për kryerjen e një ose më shumë aktiviteteve në sektorin energjetik, dhe që ka nënshkruar me OST, Kontratën për përdorimin e kapacitetit ndërkufitar, si dhe Tregtarët dhe furnizuesit e energjisë elektrike, të regjistruar në një shtet tjetër anëtar të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, kanë të drejtë të marrin pjesë në tregun e energjisë elektrike, bazuar në parimet e reciprocitetit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.*
- 2. Kudo në Rregullore termat e përdorur do të kenë të kenë të njëjtën kuptim me ligjin nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe aktet e tjera që rregullojnë sektorin e energjisë elektrike.
- 3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë subjektet “OST” sha, MIE, Autoriteti i Konkurrencës, dhe AEES për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI

https://ere.gov.al/doc/Rregullorja_e_Alokimit_te_Kapaciteteve_2018-1.pdf